



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 27864 / Prpt.

Tiranë më, 21 / 11 / 2014

Drejtuar : Të gjithë Degëve Doganore

Për dijeni : Të gjithë drejtorive pranë DPD – së

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Lënda : *Mbi delegimin e kompetencës së lëshimit të autorizimeve të përjashtimit nga TVSH – ja për makineritë e pajisjet e importuara nga fasonët dhe biznesi i vogël*

Për të lehtësuar procedurën doganore të përjashtimit nga TVSH të makinerive dhe pajisjeve të importuara nga kategoritë e tatimpaguesve fasonë dhe biznesi i vogël, mbështetur në Ligjin nr. 7928, dt. 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" të ndryshuar me Ligjin nr. 125 / 2012 dhe VKM nr. 180, dt. 13.02.2013 "Për përcaktimin e listës së makinerive dhe pajisjeve që janë drejtëpërdrejtë të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kritereve përkatës", i delegoj degëve doganore të gjitha kompetencat për të kryer procedurat doganore të përjashtimit nga TVSH – ja të makinerive dhe pajisjeve të importuara nga tatimpaguesit "fasonë" dhe "biznesi i vogël".

Baza ligjore për dhënien e përjashtimeve nga TVSH – ja për makineritë dhe pajisjet që lidhen me investimet e tatimpaguesve fasonë dhe biznesi i vogël janë :

- Ligji nr. 7928, dt. 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" ;
- Ligji nr. 125, dt. 20.12.2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7928 / 1995" ;
- VKM nr. 180, dt. 13.02.2013 "Për përcaktimin e listës së makinerive dhe pajisjeve .."
- VKM nr. 344, dt. 24.04.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 180 .."
- VKM nr. 348, 04.06.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 180 .."

Për çdo import nga kategoria *fason*, dokumentacioni duhet të plotësohet rast pas rasti sipas pikës 1 shkronja "b" e pika 3.2 dhe pikës 8 të VKM nr. 180, dt. 13.02.2013.

Kodi i procedurës shtesë në sistemin Asycuda World për këtë rast është **IP0**.

Për çdo import nga kategoria *biznesi i vogël*, dokumentacioni duhet të plotësohet sipas pikës 1 shkronja "ç" dhe pika 3.4 të VKM nr. 180, dt. 13.02.2013.

Kodi i procedurës shtesë në sistemin Asycuda World për këtë rast është BV0.


Degët Doganore çdo muaj duhet të dërgojnë në Drejtorinë Teknike pranë Departamentit të Akcizës listën e tatimpaguesve sipas kategorive që kanë përfituar përjashtim nga TVSH si dhe nga një kopje të autorizimit të përjashtimit.

Bashkëlidhur, gjeni formatin tip të autorizimit të përjashtimit nga TVSH – ja për kategoritë *fason* dhe *biznes i vogël*.

**Ky delegim kompetencash hyn në fuqi menjëherë.**

Elisa SPIROPALI

DREJTORE E PËRGJITHSHME





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Departamenti i Akcizës

Drejtoria Teknike

Nr. Prot Tiranë, më ..... /..... /2014

**A U T O R I Z I M N R.**  
PËR PËRJASHTIM NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR

EMRI I KOMPANISË SË AUTORIZUAR: Adresa:	
DEGA DOGANORE:	
NIPT:	
AFATI I VLEFSHMËRISË:	
KODI SHITESË:	IPO
BAZA LIGJORE E PËRJASHTIMIT:	Ligji Nr.125/2012 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928 datë, 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar i ndryshuar”, Neni 4 shkronja “gj”; VKM 180 datë 13.02.2013 pika 1/b, 3.2, Aneksi 1.
PËRSHKRIMI I MALLRAVE:	
DOKUMENTA SHOQËRUESE:	

VLERË : Sipas deklarimit në doganë.

SHËNIME: Të mbikqyret në import nga Dega Doganore

Konceptoi:

\_\_\_\_\_  
Kryetari Doganës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Departamenti i Akcizës

Drejtoria Teknike

Nr.

Prot

Tiranë, më ...../...../2014

**A U T O R I Z I M N R.**

**PËR PËRJASHTIM NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR**

EMRI I KOMPANISË SË AUTORIZUAR: Adresa:	
DEGA DOGANORE:	
NIPT:	
AFATI I VLEFSHMËRISË:	
KODI SHITESË:	BV0
BAZA LIGJORE E PËRJASHTIMIT:	Ligji Nr.125/2012 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7928 datë, 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar i ndryshuar", Neni 4 shkronja "i"; VKM 180 datë 13.02.2013, pika 1, shkronja "ç", 3.4. Aneksi 1.
PËRSHKRIMI I MALLRAVE:	
DOKUMENTA SHOQËRUESE:	

VLERË :                      Sipas deklaramit në doganë.

SHËNIME: Të mbikqyret në import nga Dega Doganore

Konceptoi :

\_\_\_\_\_  
Kryetari Doganës